



2016

RAPORT- TM₄ -2016




K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

www.hidroregjioni-jugor.com

PËRMBAJTJA	2
Zonat e përgjegjësish të K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”	3
I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME	4
II. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK	5
2.1 Aktivitetet – TM4- 2016	5
2.2 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	6
2.3 Prodhimi i ujit m3	7
2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim	7
2.5 Servisimi I ujëmatësave	8
2.6 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	10
2.7 Raport I Projekteve	13
III. RAPORT I SHËRBIMIT RAJONAL PËR KONSUMATORË	23
3.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	23
3.2 Aktivitetet e shërbimit të kontrolles	23
3.3 Pengesat në realizimin e objektivave	23
3.4 Masat e realizuara	24
3.5 Planet për të ardhmen	24
3.6 Raport I Performancave	25
IV. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR	43
4.1 Aktivitetet – Tm4- 2016	43
4.2 Shpenzimet – TM4- 2016	43
4.3 Treguesit e performancave	50
V. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV	59
5.1 Aktivitetet – TM4- 2016	59
5.2 Personeli – TM4- 2016	61
5.3 Raport I puneve të kryera nga gjykatat	62
VI. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSEHM	70
ORGANOGRAMI	

ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



I. AKTIVITETET E PËRGJITHSHME

FURNIZIMI

Furnizimi me uje te pijes ne nivel regional ka qene i rregullt, neper te gjitha njësitë punuese kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë.

Kompania është angazhuar dhe ka arritur që në TM-4 të vitit 2016 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku edhe kemi reduktime (kryesisht të lagja Dardanisë, pjesa e Bazhdarhanës dhe në rrugën e Janinës). Sa i perket pjeses së Bazhdarhanës kryesisht banesave kolektive, kemi bërë një ndryshim teknik të furnizimit përmes valvulave të sistemit dhe momentalisht kjo pjese ka furnizim 24 orë me ujë të pijes. Duhet cekur se ky ndryshim teknik është ende në provë dhe për çdo ndryshim të konsumit si shkak i temperaturave të larta, munde të kemi reduktime deri sa të finalizojmë projektin e planifikuar për ndarjen e furnizimit në lagjen Dardania.

Në njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e njesive operuese kemi patur furnizim të rregullët me ujë të pijes.

UJI I PRODHUAR

Për perjudhen TM-4, 2016 në nivel regional janë raportuar prodhim të ujit **4,121,979.00 m³**, krahasuar me TM-3, 2016 kemi një ulje të prodhimit të ujit të pijes prej **838,038.00 m³**. Jane duke vazhduar aktivitetet për të mbajtur gjendjen stabile të furnizimit me ujë.

FATURIMI

Në periudhën e TM4 - 2016 janë faturuar **1,721.435 m³**, apo **-380.981 (-20.7%)** më pak se në TM3-2016
Faturimi në Euro në TM4- 2016 ka qenë **1,003.301,92 €**, në krahasim me TM3 -2016 ka pas një renie prej **-154.685,51 € (-15.64%)**

INKASIMI

Në periudhën e TM4 -2016 janë inkasuar **1.022.656,48 €**, apo **-59.156,87 € (-5.5%)** më pak se në periudhën TM3 -2016.

UJI I PAFATURUAR

UPF vazhdon të mbetet një sfide kryesore e të gjitha shërbimeve të kompanisë, ku në bashkëpunim me të gjitha shërbimet si dhe duke ju falemenderuar donatoreve të huaj dhe institucioneve vendore kemi planifikuar aktivitete kryesisht në zvogelimin e UPF-se. Kompania në nivel regional ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogelimin e UPF-së që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve në terësi. Shërbimi Teknik me të gjithë sektoret e tij është duke evidentuar të gjitha rrjedhjet dhe me të gjitha kapacitetet është duke u përpjekur për sanimin e defekteve sa më shpejtë.

Raportet tregojnë që UPF në nivel regional për TM 4 - 2016 është **58,24 ose 0.69%** me rritje të UPF-së nga TM-3 paraprak.

Faturimi në nivel regional është **1,721,435.00 m³** me një ulje të faturimit prej **384,103.00 m³** krahasuar nga TM-3, 2016.

Shpenzimet në periudhën e TM4- 2016 rrinë në 954.232,11 € apo +168.263,12 (+21.5%) më të larta se në periudhën TM3 -2016.

Për periudhën TM4- 2016 kompania kishte mbulim operativ pozitiv prej 1.07 me nje dallim prej -031 nga TM3 2016 (TM3- 1.38)

II. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

2.1 Aktivitetet - Tetot- Dhjetor – 2016

*Takim ne Ministrine e Financave me Ministrin dhe delegacionine KfW-se per sfidat e implementimit te projekteve te bashkefinancuara nga R e Kosoves dhe RF e Gjermanise.

*Takim me Kruetarin e Komunes se Prizrenit per Projektin e Ujerave te Zeza, ku ne theks te vecant u shqyrtuan tri pika kryesore te cilat esencialisht kane te bejne me progresin e implemetimit te projektit te ujerave te zeza: Shpronnesimi,

Raporti i takimit me Ministrin dhe

Email nga Fejsal Hoti shef i sherbimeve publike per Buxhetin ie garantuar nga Komuna e Prizrenit per kete projekt.

*Takim me Majklin dhe Arbenin per kerkesen e Passvantit per pune shtese dhe nxjerrjen e pelqimit per vazhdimin e punimeve.

*Takim me Klaus Rothe dhe perfaqesuesit e DORSCH-it per negociimin e kontrates, ku dhe u miratuan minutat e takimit ne lidhje me Nenshkrimine kontates per asistencen Teknike.

*Dalje ne Ralin dhe fillimi i punimeve te kanalizimit pasi qe u konstatua se defekti ishte ne kanalizimin e vjeter te rruges e jo siq pretendohesh ne Kaperderdhes.

*Takim me inspektorin e Ministrise per zbatimin e ligjit te punes, i njejt sqaroj se nga sot ka afat 1 muaj per pergaditjen e dokumentacionit dhe pastaj te njejtit do te vijne ne kompani per verifikim.Takim me delegacionin e KfW-se per kontrollen e projekteve te investuara nga periudha 2005 deri 2012, te njejtit bene verifikimin e projekteve dhe ndikimin e tyre ne performancen e kompanise.

*Takim me Perfaqesuesit e KfW-se per ecurine e projektit te ujerave te zeza dhe proeektin e eficinces se energjise elektrike, te njejtit u shqetesuan per pa mundesine e fillimit te punimeve dhe konkluduan se Komuna e Prizrenit sebashku me HRJ-ne te mundohen ne cdo menyre qe te bejne presion per rregullimin e parcelave te mbetura dhe qeveria me AKP-ne keto parcela ti kthej ne emer te Komunes.Elke u sqarua per komplet mbarevajtjen e projekteve te financuara nga KfW.

*Takim me Kryetarin Muja sebashku me delegaciunin e KfW-se, me kete rast Komuna u zotua per ndarjen e fondveve shtese te projektit te ujerfva te zeza, u zotua qe do te beje te pamunduren per te shtyre proceset e shoronesimit te pronave te mbetura.

* Dalje ne teren per inspektimin e punimeve te kolektorit kryesor ne segmentin Komune-Tabahane.

*Takime javore dhe mujore me Konsulencen per ecurine e punimeve te kolektorit kryesor te ujerave te zeza per Fazen 1.

*Perpilimi i projektit ideor per furnizim me uje te pijes per fshatrat e rajonit te Anadrinise dhe Rajonit te Hasit.

*Dalje te interseptori te Marashi ku dhe u be kontrolla e pushtave per shkak te ankeses se banoreve te Ralinit.

*Takim me Konsulencen per vazhdimin e pjeses se dyte nga Tabahana deri tek Rezidenca.

*Korespondenca me Konsulencen dhe KfW-ne ne lidhje me procedurat e projektit dhe pagesave per kontraktoret.

*Takim me menaxhmentin per raportimin e aktiviteve te projektit te ujerfave te zeza.

*Perpilimi Planit bte Biznesit –Investimet Kapitale per vitet 2017-2019.

*Takim ne ARRU, per Plan Biznesin e punes, percaktimi i te dhenave teknike per vitin 2017, perafrimi i te dhenave sipas PBBRR per miratim nga ARRU,

*Takim ne MMPH dhe Komunen e Prizrenit ne lidhje me 11 parcelat te cilat ende nuk jane kthyer ne emer te Komunes se Prizrenit per Impiantin e Ujerave te Zeza,

*Dalje ne vendpunishte per Fazen 1 te kolektorit te ujerave te zeza, ne pjesen e dyte nga Komuna deri te Prokuroria,

*Korespondenc me Agent Tenderin dhe KfW-ne per projektin e Masave Shoqeruese, me crast u diskutua rreth plotesimeve te dokumentacioneve per miratim nga KfW.

*Bartja e Kontenjerit nga HRJ ne Malisheve dhe vendosja e tij tek lokacioni i puseve ne Senik te malisheves,

*Dergesa e Marrevshjes se vecant e derguar nga KfW per miratim qe Ministria e Ambientit buxhetin e vitit 2016 te perealizuar ta transferoj ne konton e vevant te KRU"HRJ"sh.a, Prizren, e cila nuk u miratua nga Ministria e Ambientit.

*Takim me Sekretarin e MMPHS-se per mundesine e transferimit te mjeteve per ITUZ ne Konton e vecant, me crast nga sekretari u tha qe nuk kemi mundesi qe keto mjete te transferohen tek KRU"HRJ"sh.a sepse nuk na lejon ligji aktual.

*Formimi i ekipes se vecant per sistemin e kanalizimit ku kompania ka marr te gjitha miratimet nga Bordi dhe menaxhmenti si dhe ka marr propozim nga KfW, Kryeshefi Ekzekutiv ka leshuar vendimin per formimin e ketije ekipe dhe deri me tani jemi ne procedure te perzgjedhjes se konkurrenteve sipas konkursit te shpallur nga kompania.

*Dalje ne vendpunishte per Fazen 1 te projektit te ujerave te Zeza.

Prej dates 15.12.2016 , jam percaktuar me vendim qe te zevendesoje kryeshefin ekzekutiv.

Aktivitetet si zevendes kryeshef ekzekutiv kan qene:

-Takim me Ministrin e MMPH-se z. Ferat Shala ne kuader te SHUKOSIT,

-Kuvendi i SHUKOSIT ne Prevalle,

-Takim me Konsulencen e Projekteve te Ujerave te Zeza,

-Takim i bordit te shukosit,

-Nenshkrimi i Kontrates per projektin e Masave Shoqeruese,

*Per raport me te holesishem posedojme raportin periodik per komplet projektin e ujerave te zeza nga Lulzim Pacarizi, Kryetar i Komitetit te Projektit.

*Aktivitet e shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale.
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit te vjeter te qytetit per eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit te ujesjellesit dhe ndarja e zanave per dedektim.
- ✚ Senzibilizimin e te gjitha konsumatoreve per mos keqperdorim te ujit te pijes permes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre te shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes te te gjitha konsumatoreve qe ta paguajn ujin ne menyre qe te rritet inkasimi dhe te kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatoreve ne sherbime dhe investime per sherbim sa me efikas te furnizimit me uje te pije

2.2 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM3, 2016

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	471	292	763
Suharekë	44	25	69
Dragash	10	07	17
Malishevë	150	24	174
Total	675	348	1023

2.2.1 Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / TM4, 2016

Njësia Operative	Ujësllësi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	522	203	725
Suharekë	59	33	92
Dragash	14	04	18
Malishevë	157	20	177
Total	752	260	1012

2.3 Prodhimi i ujit m³ - TM4- 2016

2016									
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN									
No.	Të dhënat	TM1- 2016		TM2-2016		TM3-2016		TM4-2016	
		l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
	NJËSIA P.								
1	PRIZREN	399.5	3,106,600	431.8	3,395,300	501.8	3,945,049	392.5	3,086,300
2	SUHAREKË	58.0	450,948	64.9	510,033	73.6	578,815	65.2	512,745
3	MALISHEVË	44.3	344,771	43.5	342,065	43.5	341,853	43.8	344,376
4	DRAGASH	8.9	69,300	8.7	68,600	12.0	94,300	22.7	178,558
5	TOTAL	510.8	3,971,619	548.9	4,315,998	630.9	4,960,017	524	4,121,979
	NDRY.			128.6	344,379	81.9	644,019	(107)	(838,038)
	ND-%				8.67		14.92	-16.90	-16.90

2.4 Zyra për planifikim dhe zhvillim – TM4- 2016

Për periudhen që po raportojmë në kuader të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllombimet e ujëmatësive nëpër qytetin e Prizrenit, si nga regjistrimi i kontrollës dhe në hartat: 7E122012, 7F121201, 7F121104, ku kanë arritur këto rezultate:

- Ujëmatësia të bllombuar 341 Ujëmatësia.
- Kontrata të nënshkruar 341 Kontrata.
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 524 konsumator.
- Ribllombim, bllombim për herë të dytë 190.
- Konsumatorët pa ujëmatës 18.
- Konsumatorët që janë të bllombuar 251.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje të ujit 52.
- Rekorde të reja 73.
- Kërkesa nga konsumatorët për bllombim 05.
- Konsumatorët që duhet zëvendësohet ujëmatësi 03.
- Duhet regjistruar 21.
- Regjistrim i ri 02.
- Vend i papershtatshëm 04.

	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	<i>Bllombim-Kontrata</i>	341
2	<i>Ribllombim</i>	190
3	<i>Dera Mbyllur(Heren e dyte)</i>	524
4	<i>Pa ujemates</i>	18
5	<i>Jane te bllombuar</i>	251
6	<i>Nuk kane lidhje uji</i>	52
7	<i>Duhet regjistruar</i>	21
8	<i>Rekorde te reja</i>	73
9	<i>Kerkesa për bllombim</i>	05
10	<i>Zevendesim</i>	03
11	<i>Regjistrim i ri</i>	02
12	<i>Vend i papershtatshem</i>	04

AKTIVITETET KRYESORE:

- * Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i hidrantave nëpër qytetin e Prizrenit”, Prizren.
- * Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në zonar rurale”, Prizren.
- * Mbikqyrja e projektit “Rehabilitimi i kaptazhës në Gjonaj të Hasit”, Prizren
- * Futja e të dhënave në hartat: 7F121204, 7F121102, përfundimi dhe kompletimi i të dhënave në hartat: 7F121208, 7F122107, 7F121102, 7F121101 si dhe vektorizimi i hartave: 7E122005, 7F121201, 7E122012. Përgaditja dhe pllotimi i hartave për teren.
- * Regjistrim në D.B të hartave: 7F122008, 7E122005, 7E122012 me rekorde të reja, refreshimi i hartave: 7F122108, 7E122012 dhe 7F121104, është plotësuar D.B. me shenimet e marrura nga shërbimi i inkasantave (shifra e faturës dhe Kons-it), është bërë kontrollimi i D.B (lidhja e ujit dhe instalimi i ujëmatësave) si dhe pregaditja e formularit të D.B për teren.
- * Në TM4, grupi i terrenit demontim – montim me njësi në Prizren kane arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 362 ujëmatësë, ekziston raporti i veçant.
- * Grupi i detektimi të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajve Tetor-Dhjetor, ka bërë gjithësej 160 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 110 defekte, ekziston raporti i veçant. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 7,545 m.
- * Leximi i ujëmatësave zonal për TM4, ujëmatësat në pikat matëse: Sheshi i Lidhjes, Jusuf Gervalla dhe Të ETC-ja kemi lexim të ulët ndërsa Nashec i epërm dhe Tupec puseta me ujë kurse në Landovicë kemi lexim të ulët (furnizim me ujë vetëm për shkollën që nga Janari i vitit 2015). Pikat tjera janë nën monitorim dhe janë në gjendje të rregullt për këtë muaj.
- * Po ashtu në këtë TM4 kemi pasur 7 rast për riparimin e ujëmatësave që janë sjellë nga vete konsumatorët, ekziston raporti i veçant.

2.5 Shërbimi i mirëmbajtjes - Servisimi i ujëmatësave: Korrik-Shtator, 2016

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit.

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve $\Phi(13-100)$ mm.

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	79	Ndrrimi i ujematesit DN 200 në „Galerin II“ - Kurillë
	3/4"	204	
	1"	30	
	5/4"	2	
	6/4"	0	
	Gjithsejt:	315	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	13	
	3/4"	16	
	1"	2	
	Gjithsejt:	31	
Malishevë	1/2"	7	
	3/4"	11	
	1"	0	
	Gjithsejt:	18	

Totali: 364 copa
+ 51 për „Radoniqi“-n
+ 40 testime për „CDI“ Prishtinë
455 copa

TM4- 2016

Njësia Operative	Profili Ø mm	Sasia / copë	Vërejtje
Prizren	1/2"	85	
	3/4"	244	
	1"	30	
	5/4"	3	
	6/4"	2	
	Gjithsejt:	364	
Suharekë	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Dragash	1/2"	0	
	3/4"	0	
	1"	0	
	Gjithsejt:	0	
Malishevë	1/2"	1	
	3/4"	43	
	1"	0	
	Gjithsejt:	44	

Totali: 408 copa
+ 37 për „Radoniqi“-n
+ 01 për Prishtinë
446 copa

2.6 Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për Korrik-Shtator, nga Lab. i kompanisë

Raporti i aktiviteteve dhe analizat bakteriologjike, Tetor-Dhjetor 2016

Shërbimi i përpunimit dhe kontrolli i kualitetit të ujit

Laboratori "Hidroregjioni Jugor"

Vëndi i marrjes së mostrave	Data	Përgjigjet	Nuk përgjigjet
1.Sh.f" Lekë Dukagjini"	10.10.	Po	
2.KP" Tregu i Bylmetit"	10.10.	Po	
3.KP" Xhamia Kurill"	10.10.	Po	
4." Gurra" Gjonaj	14.10.		Jo
5.KP" Tyrbe" QMF	19.10.	Po	
6.Sh.f" Avdyl Frashëri"	19.10.	Po	
7.QMF" Arbanë"	19.10.	Po	
8.Sh.f" Haziz Tolaj"	19.10.	Po	
9.Sh.f" Fatmir Berisha"	19.10.	Po	
10." Gani Tada"	20.10.	Po	
11.KP" Shadërvan"	20.10.	Po	
12.KP" Te Spitali"	20.10.	Po	
13.KP" Xhamia Tusus"	20.10.	Po	
14.KP" Xhamia Kurill"	20.10.	Po	
15.KP" Benaf" Suharekë	24.10.	Po	
16.Sh.f" Skënder Luarasi" Suharekë	24.10.	Po	
17.Gjimnazi" Jeta e Re" Suharekë	24.10.	Po	
18.Gjimnazi" Hamdi Berisha" Malishev	24.10.		Jo
19.Kroi" Xhamia Banjë" Malishev	24.10.		Jo
20." Filtri – 1" Dragash	26.10.		Jo
21.KP" Kuvendi Komunal" Dragash	26.10.	Po	
22.KP" KFOR –i Turk" Dragash	26.10.	Po	
23.Cafe" Diti" Zhur	26.10.		Jo
24.KP" Gani Tada"	27.10.	Po	
25.KP" Qoraga"	27.10.	Po	
26.KP" Shadërvan"	27.10.	Po	
27.KP" Binbashi"	27.10.	Po	
28.KP" Tyrbe" QMF	27.10.	Po	
29.KP" Tregu i Gjellbërt"	27.10.	Po	
30.Tyrbja te QMF	02.11.	Po	
31.Urgjenca	02.11.	Po	
32.ShF" Ftamir Berisha"	02.11.	Po	
33.ShF" Haziz Tolaj"	02.11.	Po	
34.QMF, Arbanë	02.11.	Po	
35.KP" Gani Tada"	03.11.	Po	
36.KP" Shadërvan"	03.11.	Po	
37.KP" Binbashi"	03.11.	Po	
38.KP" Te Spitali"	03.11.	Po	
39.Xhamia Tusus	03.11.	Po	
40.Kom.Mbledhëse, 40 Burime	11.11.	Po	
41.KP" Qoraga", 2x	11.11.	Po	
42.KP" Adem Jashari", 2x	11.11.	Po	
43.KP" Qoraga"	15.11.	Po	
44.KP" Tregu u bylmetit"	15.11.	Po	
45.Emergjenca	15.11.	Po	
46.Ambulanca, Arbanë	15.11.	Po	
47.KP" Qoraga"	24.11.	Po	
48.KP" Binbashi"	24.11.	Po	

11

49.KP"Shadërvan"	24.11.	Po	
50.ShF"Abdyl Frashëri"	24.11.	Po	
51.KP"Te Spitali"	24.11.	Po	
52.Sllapuzhan, pusi	02.12.		Jo
53.Tyrbja	06.12.	Po	
54.Sh.F."Abdyl Frashëri"	06.12.	Po	
55.Tregu I Gjelbërt	06.12.	Po	
56.KP,Rr.Adem Jashari	06.12.	Po	
57.KP"Tregu I bylmetit"	06.12.	Po	
58.KP"Gani Tada"	13.12.	Po	
59.KP"Shadërvan"	13.12.	Po	
60.KP"Binbashi"	13.12.	Po	
61.KP"Te Spitali"	13.12.	Po	
62.KP"Kurillë"	13.12.	Po	
63.Filtri 1,Dragash	15.12.		Jo
64.KFOR-I Turk,Dragash	15.12.		Jo
65.Koi,KRU-Dragash	15.12.	Po	
66.Caffe"Diti",Zhur	15.01.		Jo
67.Sllapuzhan,Pusi	16.12.		Jo
68.QMF	21.12.	Po	
69.ShF"Abdyl Frashëri"	21.12.	Po	
70.KP"Adem Jashari"	21.12.	Po	
71.ShF"haziz Tolaj"	21.12.	Po	
72.QMF, Arbanë	21.12.	Po	
73.Kushnin	27.12.		Jo
74.Kabash I Hasit	27.12.		Jo
75.KP'Benaf",Suharekë	28.12.	Po	
76.Gjimnazi "Jeta e Re",Suharekë	28.12.	Po	
77.SHFM"Skender Luarasi",Suharekë	28.12.	Po	
78.Gjimnazi"Hamdi Berisha",Malishevë	28.12.	Po	
79.te Xhamia,Banja e Malishevës	28.12.		Jo

Aktivite tjera:

- Kontrolli I Cl-rezidual në të gjitha pika të furnizimit, kontrolli I paisjeve dhe procesi I klorifikimit në stacionet e klorifikimit si dhe kontrolli I rregullt i burimeve dhe sasisë së ujit;
- Vizita në Era Med- Prishtinë për reagjent dhe diskutim rreth çështjes se sit ë liferohen reagjentët në sasi të nevojshme për të ardhmen;
- Përgaditja e dokumentaciont për material dhe reagjent për tenderim si dhe vizita disa ditore në zyrën e Prokurimit për të qartësuar në detaje dokumentin e përgaditur për tender;
- Vizita në shtëpinë e një konsumatori, rr.Janina, pas ankesës së saj për kualitet të ujit.Është konstatuar se problemi është I mbrendshëm dhe se ska të bëjë me kualitet të ujit të pijshëm. Hidrofori në gjendje jo të rregullt;
- Punimi I analizave të një mostre të marrur në Gjonaj, burim i ri, në ISHP, pasi që fotometri I laboratorit është jashtë funksionit.Duhet të bëhet kalibrimi sa më I shpejtë në ndonjë institucion adekuat në Prishtinë;
- Vizita, me kolegët nga Ferizaji dhe Suhareka, të disa fshatrave ku do të instalohen paisje të nevojshme për aktivizimin e procesit të klorifikimit; Furnizimi i rregullt me Ujë Zhaveli për fshatrat e Hasit, Kushnin dhe Kabash.
- Kontrolli permanent të klorit rezidual në të gjitha pika të furnizimit, kontrolli I burimeve si dhe të stacioneve të klorinimit; Pranimi I klorit gaz prej furnizuesit të rregullt, 2 x 1t;
- Kemi marrë bombolën 150 kg klor gaz prej Pusit të Atit që kanë huazuar më parë;
- Shtimi I kontrollës nëpër objekte të furnizimit dhe të klorinimit si dhe kontrolli I klorit residual pas rreshjeve të mëdha;
- Për shkak të rreshjeve të mëdha kemi qenë të detyrar të shkarkojmë ujin prej komorës mbledhëse në 40 Burime dhe të kaptazhës IV-të;
- Kemi aktivizuar pompat si alternaiv për furnizim;

- Për këtë arsye kemi njoftuar mjetet e informimit se ujin për nevoja të pijes nuk duhet të përdorin deri në informimin e radhës nga ana e Hidroregjionit Jugor;
- Për shkak të situatës të lartëcekur kemi shtuar kontrollimet e ujit ne burime dhe teren dhe pasi që kemi konstatuar se uji është pastruar në tërësi dhe se klori residual ka figuruar në sasi të nevojshme në të gjitha pikat e furnizimit kemi informuar mediat;
- Përgaditja disa ditore të dokumentacionit për deklaratën e nevojave të materialit për tender në bashkëpunim me pjestarët për prokurim;
- Përgaditja e dokumentacionit gjegjësisht kërkesës për shërbime të konsulencës për akreditim të aprovuar nga Kryeshefi Ekzekutiv;
- Pasi që fotometri ka qenë jashtë përdorimit kemi dërguar në riparim në Prishtinë dhe pas 2 jave është riparuar dhe është në funksion;
- Me kërkesë të CDI-së znj.Hajrije kemi vizituar zyret e tyre në Prishtinë për të diskutuar mënyrën e organizimit të një seminari/trajnimi për të gjithë ata që mirren me çështjen e klorifikimit, dhe këtë kemi oraganizuar në mënyrë shumë të sukseshme në Kushnin të Hasit;
- Dërgesa e rregullt e Hipoklorur Natriumit në Kushnin.
- Përcjellja permanente të klorit residual në të gjitha rrjetat e furnizimit;
- Marrja e mostrave bakteriologjike dhe fiziko-kimike;
- Në Sllapuzhan ishim 2x për të marrë mostra prej pusit të ri;
- Për shkak të insistimit të KFOR-it Austriak në Suharekë kemi pasur dy takime në lidhje me procesin e klorifikimit si dhe kemi vizituar disa pika prej nga bëhet klorifikimi për Suharekë. Pas sqarimeve të thukëta nga ana e përfaqësuesve të HRJ, janë nda tepër të kënaqur;
- Kami marrë pjesë në seminarin të organizuar nga ISHP-Prizren. I tërë stafi për kontrollin e ujit;
- Dërgesa e rregullt e Na-hipoklorurit për nevoja të fshatrave të Hasit, Kabash, Kushnin fje I.
- Shumë herë kemi pasur problem me veturën.

Analizat Bakteriologjike ISHP-Prizren

Prizren – prej 149 analizave, të gjitha i përgjigjen (përbëjnë klor residual prej 0.2 – 0.3 mg/l);
 Dragash – prej 5 analize, të gjitha i përgjigjen; Suharekë – prej 18 analizave, 2 nuk i është përgjigjur;
 Malishevë – prej 14 analizave, 3 nuk i është përgjigjur.

2.6.1 Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren TM3- 2016

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	00	00
	Ujësjiellës	158	00
Suharekë	Burim	00	00
	Ujësjiellës	12	00
Dragash	Burim	00	00
	Ujësjiellës	03	00
Malishevë	Burim	01	01
	Ujësjiellës	13	02
Totali		186	02

2.6.2 Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren TM4- 2016

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	00	01
	Ujësjiellës	149	00
Suharekë	Burim	00	00
	Ujësjiellës	18	02
Dragash	Burim	00	00
	Ujësjiellës	05	00
Malishevë	Burim	00	00
	Ujësjiellës	14	03
Totali		186	05

*analizat e ujit të burimeve nuk mirren në konsideratë, uji i patrajtuar.

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjellësit është 186 dhe nga këto 5 mostëra nuk i pergjigjet.

2.7 Raporti i Realizimit të Projekteve

2.7.1 Aktivitetet e Ujerve te Zeza – Korrik-Shtator, 2016

Faza e pare I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

- Të dhënat Teknike

-Gjithsejt gjatesia e kolektorit qe do te instalohet eshte rreth 5100m.

- Diematri i kolektorit fillon nga DN500mm deri ne DN1200mm ne hymje te ITUZ-se dhe DN 1000mm ne dalje te ITUZ-se.Tipi i gypit eshte HDPE i brinjezuar SN8(CL 8kN/m²) dhe Gize K9

- Kolektori do te vendoset ne rruge ne anen e djathte te rrjedhjes se Lumbardhit dhe do te te vendoset ne vendin e kolektorit te vjeter, ku do te perfshije keto rruge: Enver Haradinaj, Remzi Ademaj, pjeserisht Wiliam Wolker, Rrugen magjistrale M25 deri tek ITUZ, ndersa vazhdimi i kolektorit nga rrethi i fshatit Hoqe e Qytetit deri tek kyqeja Jugore e Autostrades do te kaloje ne mes te rruges M25 pastaj nga ky pozicion do te vazhdohet deri tek kyqeja ne ITUZ.

Çmimi

-Vlera e punimeve sipas kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU“Hidroregjioni Jugor” Sh.A eshte: 2,043,273.00 Euro.

Afati (data) i fillimit te punimeve

-Sipas planit dinamik te pershkruar ne kontrate punimet duhet te fillojne te Henen me 15.12.2014 dhe duhet te perfundojne te Henen me 12.12.2016, mirpo per shkak te vonesave ne rregullimin e pelqimeve dhe lejeve te cilat jane te domosdoshme per fillimin e punimeve kemi pasur ngecje ne fillimin e realizimit te punimeve ne teren.

-Perfundimisht pas marrjes se te gjitha pelqimeve dhe Lejes nga Drejtoria per Planifikim dhe Urbanizem punimet kane filluar me date 06.06.2015 pasi qe eshte bere furnizimi me material konform kontrates.

Progresi i punimeve ne Faza e pare I te projektit

Ne Pjesen A (Task A) deri me tani jane realizuar hapja e kanalit, vendosja e zhavorit,vendosja e gypave, mbulimi I kanalit te gjitha keto sipas detaleve te dhena ne projekt dhe ate;

Instalimi i Gypave te kolektorit 1265 m.

-Gypi DN800mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1215 m,

-Gypi DN1000mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1300 m,

Instalimi i pusetave nga P101 deri P151 gjithsej 150 pusetave, si dhe te gjitha pjeset percjellese.



Fig 1. Punet ndertimore Task A, P117 to P12

Kane perfunduar punimet ne ndertim te pusetes shkarkuese (kaperderdhesit) CSO S1 tek rrethi i fshati Hoqe e Qytetit, ku ky kaperderdhes eshte ndertuar brenda trupit te rruges M25 dhe njeherit bene lidhjen e kolektorit ekzistues me ate te kolektorit te ri.



Fig 3. Punet ndertimore Task B, Rr Remzi Ademaj-Nga Hotel Theranda deri te Komuna

Obligimet ndaj kontraktorit

Ne baze kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte realizuar edhe pagesa e avansit me vler 20% te kontrates mjete keto te siguruar nga Qeveria e Republikes se Kosoves permes ministris se linjes MMPH.

Sa i perket furnizimit me material nga kontraktori ne si Hidroregjion kemi bere kerkesat e duhura ne MZHE per mundesine e lirit nga taksat doganore, i kemi derguar ne MZHE te gjitha dokumentet e nevojshme ne lidhje me mundesine e lirit nga Taksat doganore per pjesen qe do te financohet nga KfW.

Momentalish kane filluar punimet tek CSOS1g te Marashi dhe kolektori te lokacioni i ETC-se Eshte nenshkruar IPC 1-Fatura e pare per punekryerje te Fazes I nga ana jone dhe eshte derguar tek Passavante, e cila pastaj duhet te dergohet tek KfW pasi qe kjo pagese do te kryhet nga KfW.

Kontigjenti i dyte per Fazen I i furnizimit pas kerkeses sone dhe plotesimit te dokumentacionit perkates ne MZHE, eshte liruar nga TVSH-ja.

Ne muajin Prill kan filluar punimet per ndrrimin e gypit ne rrugen Remzi Ademaj ne pjesen prej Komunes deri tek Hotel Theranda, me nje gjatesi preh 475m , deri me tani kemi perfunduar afersisht 60% te ketije segmenti, njekohesisht eshte bere edhe ndrrimi gypit te ujesjellesit ne kete rruge. Eshte instaluar gypi i kanalizimit me je distance prej 30m dhe kycja ne kolektorin e ri.

Punimet jane duke vazhduar ne kete segment dhe shpresojme qe do te perfundojne sipa planit dinamik te paraqitur nga Kontraktori.

Ne fund te muajit Maj kan perfunduar punimet ne pjesen prej komunes deri tek Theranda te kolektorit te ujerave te zeza.

Sipas drejtorit të shërbimeve publike në komunën e Prizrenit, nuk do të jepet leja për zhvillimin e punimeve për muajin Qershor, Korrik dhe Gusht, arsyja është pengesa në qarkullimin unazor të qytetit si shkak i ngarkesave nga vizitat të cilat i ka qyteti i Prizrenit.

Gjate muajit qershor është dhënë leja nga DSHP-ja në Prizren për pjesën e Mulliri në Tabahane, janë duke u zhvillur punimet sipas planit dinamik të parapare nga kontraktori.

Sa i përket Fazës 1 deri në fund të vitit 2016 janë perfunduar rreth 90% e punimeve, si punë të cilat kanë mbetur për vitin 2017 janë:

Disa punë finale në Task B përfshirë dhe kycjen në rrjetin egzistues të Kanalizimit tek Gjykata Themelore.

Vazhdimi i Task A, Gypi Paj Pasi dhe Gypi shkarkues nga ITUZ-*ja deri në Lumbardh

Pjesa nga shkarkimi i pare të 34-shi deri tek Kaperderdhesi në Ralin,

Faza testuese e sistemit të projektit FAZA 1.

Sa i përket Pagesave të rregullta, pagesave për punë shtesë (Varicion order), pagesave për shkak të vonesave (Claim-ave) pagesave për TVSh dhe Dogana, ende janë në proces dhe PASSAVANTE i ka skaduar garancionet për Pagesë të Avancit dhe Garancioni i performancës, pa këto garancione valide Passavantit nuk do të bëhet asnjë pagesë e radhës nga KfW-ja.

Faza e dytë II e projektit:

“Dizajnimi dhe ndërtimi i Impiantit për trajtimin e ujerave të zeza”

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, për realizimin e këtij projekti me datë: 05.05.2015 është nënshkruar kontrata në mes të kompanisë AQUALIA nga Spanja si dhe KRU“Hidroregjioni Jugor”Sh.A, vlera e kontratës është 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrëveshjes kontraktuale për këtë projekt duhet të paguhet avanci me vlerë prej 20% e vlerës së kontratës, pagesë të cilën duhet ta paguaj MMPH.

-Deri me tani konform marrëveshjes speciale të reviduar nga ana e kontributit vendor janë paguar në emër të avancit për Fazën II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar në Marrëveshjen e vecantë në të cilën është qartësuar planifikimi i mjeteve për kontributin vendor dhe kontributin e jashtëm, është riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave të takimit të datës 14 Tetor 2015 të nënshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW është parapare:

Kontributi vendor i ndryshuar pas marrëveshjes së reviduar speciale e cila ka parapare këtë buxhet.

2014	FAZA I	99.763.70 €
2015	Pjesa e parë e vitit FAZA I	374.275.82 €
2015	Pjesa e dytë e vitit FAZA I	625.000.00 €
2016		2.100.000.00 €
2017		1.800.960.48 €
		5.000.000.00 €

Aktivitetet e ndërtimit Faza 2

Kontraktori ka finalizuar çështjet e mobilizimit dhe ato administrative. Faturat e pagesës së avansit është dorëzuar.

Tani kontraktori është duke punuar në projekt,

- përditësimi i trasesë (layout) së Impiantit për Trajtimin e Ujerave të Zeza në bazë të kërkesave të punëdhënësit,
- përgatitja e orarit të projektimit dhe planit dinamik është në progress,
- kordinimi për zhvendosjen e linjës së rrymës elektrike mbitokësore me KEDS-in,
- kordinimi i pikave kyqëse të furnizimit me rrymë për Impiantin për Trajtimin e Ujerave të Zeza me KEDS-in,
- kontraktori do të angazhojë një kompani për të bërë matjet gjeodezike.

Periudha e projektimit është 120 ditë. Për të shmangur vonesat për shkak të dokumenteve jo të kënaqshme të projektit, është pajtuar që të dorëzohen projektet në pako.

Pakoja e parë – Projekti Konceptual i Azhurnuar u dorëzua më 24 Korrik

- Që përbëhet nga një vizatim i trasesë (layout), P&ID, profil hidraulik.

Pakoja e dytë – Projekti Kryesor pritet me datën 30 Shtator

- Vizatimet që kërkohen për marrjen e lejes për projektet e kategorisë III, p.sh. projektet civile për të gjitha strukturat dhe njësitë, të gjitha vizatimet layout (të përgjithshme, gypat, rryma,

rrugët, hapësira, etj), vizatimet e azhurnuara të projektit konceptual. Ku kjo pako eshte prezantuar ne takimi e fundit te mbajtur ne HRJ ne fillim te muajit Nentor 2015

Pakoja e tretë – Projekti i Detajuar pritet të jetë pjesërisht krahas me progresin në ndërtim.

- Vizatimet detale që kërkohen për ndërtimin e secilës njësi/ndërtesë/strukturë, duke përfshirë kalkulimet statilke, lista e paisjeve etj. (krahas progresit të projektit).

-Ne takimin e fundit gjate muajit tetor kemi patur nje takim me kontraktorin e Fazes II dhe Konsulencen ku dhe kemi diskutuar ne lidhje me shtrirejen-situacionin e brendshem te impiantit, qe nenkutupon metoden e trajtimit, shtrirejen e objekteve administrative dhe percjellese, dhe pritet miratimi nga ana e HRJ-se.

-Punëdhënësi HRJ ka shprehur gadishmërinë për t'i asistuar Kontraktorit në të gjitha çështjet për të marrë lejet e kërkuara. Ligjet relevante dhe udhëzimet administrative iu janë dhënë Kontraktorit.



Pamja e ITUZ-se ne 3D

-Per shkak te pengesave nga pronaret e shpronësuar nuk ka aktivitete të ndërtimit deri më tani

-Ne se bashku me konsulencen dhe kontraktorin ne nje takimi ne zyren e DSHP-se dhe permes nje shkrese elektronike e kem njoftuar DSHP ne komunën e Prizrenit, per pengeset qe i kemi nga pronaret e shpronësuar te lokacionit ku do te ndertohet ITUZ dhe kemi kerkuar nga DSHP si bartese e projektit per shpronësime qe te ndermarre masat e duhura qe mos te ngecim me projektin ne fjale pasi qe cdo vonese do te reflektoje ne kosoton e projektit si dhe do te rrezikoj investimin ne pergjithesi.

-Pas bisedës telefonike qe kam pas me zyrtarin komunal ne zyren e pronave ne komunën e Prizrenit, z. Gursel Skenderi, me eshte thene se pa u paguar edhe centi i fundit tek [pronaret ne nuk kemi te drejte qe pronat e tyre ti bartim tek Komuna.

-Sa i perket lejes se ndertimit te cilen duhet ta kerkojme tek Departamenti i ndertimit ne MMPH, paraprakisht duhet nxjerre dokumenti i VNM-se , i cili po ashtu kerkon kriterin kryesor shpronësimit perfundimyatre te lokacionit, prandaj ne rast se kemi pengesa ne pagesen e pronarve, komuna e prizrenit duhet te krijojte nje KONTO MIREBESIMI ne te cilen duhet te derdhe te gjitha mjetet e parapare per shpronësime dhe ne momentin qe do ta kemi kete dokument do te fillohet me perpilimin e VNM-se si kusht kryesor per posedimin e lejes se ndertimit nga MMPH.

Perpos takimeve per mbarevajtje te punimeve nuk kemi patur ndonje progres te theksuar ne lidhje me Projektin ne fjale,

Pas takimit me Drejtorin e sherbimeve publike ne nje konference i njeiti gojarisht me tha qe sa i perket kontos se mirebesimit ajo do te nxjerret nga komuna vitin e ardhshem ne fillim te 2016-tes.

Pronat e shpronësuar tani me jane bartur ne emer te Komunes se Prizrenit dhe pritet qe shume shpejt ky lokacion te na jepet ne shfrytëzim ne si KRU"HRJ" me crast dhe do te kemi mundesi qe ti plotesojme kushtet per leje te ndertimit ne MMPH.

Per shkak te ketyre vonesave ne kemi hyre ne obligime shtese ndaj kontraktorit AQUALIA afersisht 170,000.00 euro.

Ne me kohe i kemi bere kerkesat per paisje me te gjithë dokumentacionin i cili duhet te pergaditet nga organet komunale dhe qendrore per Fazën 2 te ketije projekti.

Pas takimit javor qe kemi pas me kontraktorin e Fazes 2 dhe Konsulencen e kemi perpiluar nje plan se kur munde te merret leja e ndertimit nga MMPH dhe kur munde te kemi casje legale ne vendin ku do te ndertohet ITUZ.

Sipas ecurive te procedurave ne kemi parapare qe me se largu deri me daten 15 Korrik 2016, kontraktori munde te filloje me mobilizimin dhe rrethomin e lokacionit ku do te ndertohet ITUZ.

Per ecurine e komplet projektit kemi ne dispozicion Raportin Periodik te cilin e perpilon Konsulenca dhe e dergon tek KRU"HRJ dhe KfW.

Pas dorezimit te gjithë dokumentacionot per kushtet ndertimore per ITUZ-ne, MMPH ka konkluduar se fillimisht do te leshohen Kushtet ndertimore vetem per te filluar me mobilizimin e puneve te cilat do te behen ne lokacionin e ITUZ-se, koha kur do te leshohen kushtet ndertimore eshte me 16 Shtator, 2016, pas kesaje do te aplikohet per leje ndertimore e cila nenlupton fillimin e ndertimit te ITIZ-se.

Kemi korespondenca te rregulltga me KfW dhe Konsulencen ne lidhje me Pagesat, taksat, pelqimet etj.

Per te dy fazat kemi Raportet Periodike te pergaditura nga Konsulenca.

Per shkak te Lejes se ndertimit ende nuk kemi mundesi te fillojme punimet ne Fazen 2 te Projektit.

Edhe ne muajin Tetor nuk ka ndonje levizje ne aspektin e fillimit te punimeve ne Fazen 2 te projektit te ujerave te zeza, per mkmentin ende nuk kemi ndonje levoizje nga Komuna e Prizrenit per 11 parcelat qe menaxhohen nga AKP-ja, te cilat duhet te barten ne emer te Komunes se Prizrenit.

Sa i perket fillimit te punimeve per Fazen 2, Kontraktori me daten 14.11.2016, ka filluar me punet pergaditore.

Sa i perket pagesave per vonesa, ne kemi perfunduar pagesat prej 1 deri ne 8, ku per tu proceduar keto pagesa nga Komuna e Prizrenit e cila i ka ndare mjetet, ne fillimisht duhet te marrim miratim nga KfW, ti kompletojme dokumentet dhe ti dergojme ne Drejtorine e Sherbimeve Publike.

Per me gjeresisht posedojme raportin Periodik nga Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi.

2.7.2 Projekti rajonal - Prizren për ripërtrirje të energjisë dhe energjisë efiçiente.

Titulli i projektit;	“Ndërtimi i gypsjellësit të ri në segmentin 40 Bunarët – rez. ‘Shpati’ respektivisht kyçja në rrjetin e qytetit të Prizrenit”.
Përfituesi;	KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A – Prizren
Donatori;	Qeveria Gjermane – BMZ - 2007 65 941
Agjensioni financiar;	KfW – Banka zhvillimore
Fondi total i programit;	2.5 mln Euro
Data e Marrëveshjes;	11.12.2013
Konsulenca;	p2mberlin – ndërmarrja kryesore IDOM – partner Alb-Architect, nënkontraktor
Data e Kontratës;	14.05.2014
Plani dinamik;	9 muaj
Plani I dinamik i reviduar;	Prill 2016 – Dhjetor 2016 (9 muaj)
Plani dinamik aktual;	Prill 2017 – Dhjetor 2017 (9 muaj)
Periudha e përgjegjësisë dhe përfundimi i projektit;	Dhjetor 2018

Tenderimi i fazës
parakualifikuese;

Është përfunduar faza parakualifikuese e tenderimit sipas shpalljes publike me datë 29.08.2014 deri 19.10.2014 dhe nga 19 ndërmarrjet që kanë tërhequr materialin për ofertim, 8 prej tyre kanë ofertuar dhe përfundimisht pas vlerësimit 6 ndërmarrje kanë përmbushur kriteret për procedim të fazave vijuese.

Tenderimi i fazës teknike
dhe financiare;

Pas përgatitjes së projektit detal e zbatues i cili fatkeqësisht ka shpenzuar një kohë të gjatë, është shpallur tenderi për fazën teknike dhe financiare në periudhën prej 09.01.2016 deri më 24.02.2016. Dokumentacioni u është dorëzuar 6 ndërmarrjeve konkurrese të parakualifikuara në fazën e I-rë.

Është bërë hapja e ofertave me datën 24.02.2016 dhe aktualisht jemi në procesin e evaluimit të fazave teknike dhe financiare në bashkëpunim me ndërmarrjen konsulente “p2mberlin”. **Çmimet ofertuese pas revidimit dhe përmirësimit sillen prej 1,766,187.68 € (1,925,152.68 €) (Rai Commerce) gjer 2.418,272.66 € (2.418,314.52 €) (AI Trade).**

Draft evaluimi I parë I ofertave të fazës teknike dhe financiare nga konsulenca dhe Kompania jonë është dërguar KFW-së për miratim me datën 19.04.2016. Jopajtueshmërinë përkatësisht kërkesën për rivlerësimin rreth këtij evaluimi e kemi pranuar me datën 27.05.2016, nga z. Michale Pucher. Është dërguar rivlerësimi I dytë nga konsulenca e cila gjithashtu është shoqëruar me jopajtueshmëri deri në draftin e fundit të rievluimit të datës 26.07.2016 I cili është proceduar për shqyrtim dhe miratim nga KFW.

Pëlqimet dhe leja e punës

Për t'i qëndruar karshi zotimeve tona, qysh me datën 19.01.2016 kemi filluar me aplikimin në institucionet kompetente për marrjen e Pëlqimeve përkatëse për lejen e punës për të përfituar nga koha dhe për të evituar ngecjet eventuale në procedim final. Të gjitha Pëlqimet I kemi siguruar përveç nga MI të cilët në parim janë pajtuar për mospengimin e realizimit të projektit mirëpo kërkojnë të zgjidhet punëmarrësi I cili pastaj paraprakisht të bëjë studimet gjeologjike të trasës rrugore dhe të hartoj e prezentoj planin e saktë dinamik.

Plani i parashikuar dinamik
i kontraktimit dhe punimeve;

Sipas procedurave standarde që aplikon KFW, pas negociatave, sqarimeve dhe klarifikimeve të nevojshme me ofertuesin e propozuar nga konsulenca dhe KRU “H. Jugor”, nga KFW-ja parashihet një periudhë e caktuar kohore për pajtueshmëri gjegjësisht moskundërshti të përzgjedhjes së punëmarrësit. Afati I paraparë I vlefshmërisë së evaluimit të dokumentacionit ofertues është shtyer deri me 26.08.2016 çka nënkupton se deri në këtë afat duhej të bëhej përzgjedhja e punëmarrësit.

Është zhvilluar takim I parë konsultativ ne datën 31.08.2016 në lokalet e Kompanisë sonë, me ofertuesin potencial “Raicommerce”, nga Bullgaria dhe janë shtruar çështjet për klarifikim sikurse është kërkuar të plotësohet dokumentacioni I munguar apo I skaduar nga validiteti. Gjithashtu është dakorduar që para nënshkrimit të kontratës të organizohet një takim me përfaqësuesit e MI-së për harmonizimin e kriterëve për ekzekutimin e punimeve.

Memorandumi I Mirëkuptimit (MM):

Pas disa takimeve konsultative dhe shkëmbimit të informacioneve e të dhënave të kërkuara, me datën 15.12.2016 është nënshkruar MM në mes 4 palëve; MI, KK-Prizren, KRU “Hidroregjioni Jugor” dhe konsulenca “p2mberlin”. Me këtë MM është siguruar edhe Pëlqimi adekuat për zhvillimin e punimeve konform lejes urbanistike dhe konditave të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Statusi aktual, Janar 2017;

Me datat; 21.11.2016 respektivisht 21.12.2017 janë dërguar dokumentet finale të kërkuara nga KFW – 1. MM, 2. Vendimi I qeverisë për zonat mbrojtëse ujore (shqip dhe anglisht), 3. Projektpropozimi ideor për përcaktimin e zonave mbrojtëse të burimit të ujit – “40 Bunarët”, 4. Listat poseduese të të gjitha parcelave nga DGJK, 5. Trasa gjeodezike nga DSHP, 6. Leja Urbanistike nga DU dhe dokumentacioni tjetër relevant. KFW pas procedimit të këtij dokumentacioni, para nënshkrimit të kontratës shtron çështjen e zonave dhe masave për mbrojtjen e burimeve të ujit. Me shkresën e datës 17.01.2017 kërkohet të sigurohet Pëlqimi apo shkresa zyrtare nga MMPH-ja për çështjen e sigurisë së vendburimit dhe zonave I dhe II mbrojtëse të cilën aktualisht jemi në fazën e procedimit final.

2.7.3 Titulli i programit-GIZ: Zhvillimi i kapaciteteve për Politikat Klimatike ndërkombëtare

Titulli i projektit:	“Mbrojtja e mjedisit përmes efijencës në përdorimin e energjisë në sektorin e ujërave dhe kanalizimeve”.
